



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**C-IV-13-2463**

*Parashtruesi i Ankesës*

V Š, nga Peja, me vendbanim aktual në Beograd të cilën në kuadër të P Graqanicë e përfaqësojnë av N T, nga Fushë Kosova dhe G M, nga Shterpce

*Kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) ( NSH “N R” në likuidim), Rr. “Agim Ramadani” nr.23, Prishtinë**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 20 shtator 2021, lëshon këtë:

### **AKTGJYKIM**

- I. Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ130-0133 datë 9 shtator 2013.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 21 tetor 2013, pranë DHPGJS, ankuesja parashtror një kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PEJ130-0133 të datës 9 shtator 2013 (tani e tutje Vendimi), me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim të pagave të papaguar, në shumë prej 3,600.00 (tre gjashtë zero zero) Euro ndaj NSH “N R” (në likuidim).

Ankuesja fillimisht kundërshton Vendimin e AL, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, shkeljes së dispozitave procedurale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike.

Ankuesja pohon aplikimin e gabuar nga ana e AL dispozitave ligjore lidhur mbi parashkrimin. Tutje, ankuesja, pohon se i është mohuar e drejta e qasjes në organet e drejtësisë, sipas nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (KRK) lidhur me nenin 6 të Konventës Europiane mbi të drejtat e njeriut (KEDNJ) dhe nenit 1 protokollit 1 të KEDNJ, si dhe nenit 24 të KRK lidhur me nenin 14 të KEDNJ.

Ankuesja pohon se për shkak të rrethanave të njohura botërisht, në qershor të vitit 1999, ishte e detyruar që për shkaqe të sigurisë ta lëshoj Pejën e njëherit edhe vendin e saj të punës. Tutje pohon se është e diskriminuar dhe se ky diskriminimi, i punëtorëve të nacionalitetit Serb, është konfirmuar edhe me Aktgjykimin e DHPGJS , sipas lëndës SCEL-09-0007.

Ankuesja gjithashtu pohon shkeljet e dispozitave ligjore të Ligjit mbi punën e bashkuar.

Nga të gjitha arsyet propozon që Vendimi i AL të priset dhe të kthehet në rivendosje apo që të aprovoj kërkesën e saj si të bazuar.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL, dhe
- Kërkesa për lirim nga pagesa e taksave gjyqësore dhe ndihmë në përkthim.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 25 korrik 2014, parashtrij përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP mbështeti Vendimin e AL si të bazuar dhe në përputhshmëri me dispozitat ligjore. AKP pohoj se kërkesa kreditore, në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP lidhur me dispozitat ligjore të Ligjit mbi punën e bashkuar dhe Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, është parashkruar. AKP me përgjigje i referohet vendimeve të DHPGJS. Nga gjitha AKP propozoj që ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit mbi fillimin e procedurës së Likuidimit të NSH.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, ankuesja me 10 shtator 2014 parashtrij përgjigjen.

Ankuesja mbeti në tërësi si pranë ankesës.

Ankuesja po me 10 shtator 2014, me anë të parashtrësës së veçantë parashtrij kopjen e autorizimit për përfaqësuesit e saj.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 5 nëntor 2014, parashtrij kundërpërgjigjen.

AKP mbeti në tërësi si pranë përgjigjes.

### **Arsyetimi Ligjor**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesja ishte në marrëdhënie pune pranë NSH gjer në qershor të vitit 1999.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankueses, që në parashtrirat e saj me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsytimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesja, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Lidhur me pagat e papaguara, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritetet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankueses, nuk janë paguar;
- b. kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- c. pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- d. ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Ankuesja për më tepër nuk ka dëshmuar të drejtën e saj mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1.

Gjykata gjithashtu shqyrtoj pretendimet e ankuesit lidhur me shkeljet ligjore lidhur me aplikimin e dispozitave ligjore të Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative si dhe KEDNJ. Në rastin konkret AL procedurën e likuidimit e ka zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për AKP (Shtojca e Ligjit) si ligj i veçantë i cili rregullon çështjen e likuidimit të NSH dhe i cili ligji konsiderohet si "*lex specialis*". Gjithashtu ankueses, i është mundësuar qasja e lirë në këtë procedurë dhe se kërkesa e saj është trajtuar në pajtim me dispozitat ligjore. Nga gjitha këto arsye, gjykata nuk gjeti shkelje të dispozitave të KEDNJ.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

### **Taksa Gjyqësore:**

Ankuesja ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar